



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga 5672
dhe mban nga dërguesi nr. 292 prot
datë 23.07.2025 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda) _____

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 2816 datë 25.07.2025

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z _____

-Znj/Z Relatant të Peshkopi

-Znj/Z _____

-Znj/Z _____

me porosinë: _____


Shënim: Hëni përshkruar sipas ligjit.

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë _____

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore: Imet ofitave

Peshkopi, me 25075 2025

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 23/07/2025

Nr. 5672

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Dibër ✓

Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi

Partisë Socialiste të Shqipërisë

Sheshi "Austria" Tiranë

Zj. Majlinda Xhevat Poçi

Peshkopi, Dibër

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 17.07.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Majlinda Xhevat Poçi.


Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr. 1352, datë 17.07.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Sekretar i Përgjithshëm

(në mungesë dhe me urdhër)

Aurel LAMCE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

Data: 17.07.2025

Nr: 1352

Ora: 13.00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË DIBËR ME KANDIDATIN
NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË", ZJ.
MAJLINDA XHEVAT POÇI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 4993 prot., datë 30.05.2025, Këshilli i Bashkisë Dibër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Alma Nin Selami, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për Këshillin e Bashkisë Dibër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 15, zj. Majlinda Xhevat Poçi.

Me shkresën nr. 5025, prot., datë 02.6.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatis për anëtar në Këshillin e Bashkisë Dibër zj. Majlinda Xhevat Poçi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet

Data: 17.07.2025 Nr: 1352
Ora:13:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" zj. Majlinda Xhevat Poçi"

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit "Partia Socialiste e Shqipërisë", ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër DI-PS-18639_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Majlinda Xhevat Poçi, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit me shkresën nr.5113 prot., datë 10.6.2025, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, dhe me shkresën nr.5112 prot., datë 10.6.2025, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për zj. Majlinda Xhevat Poçi.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1433/1 prot., datë 17.6.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Majlinda Xhevat Poçi, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.9020/1 prot., datë 17.6.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Majlinda Xhevat Poçi, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Majlinda Xhevat Poçi në Këshillin e Bashkisë Dibër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"





VENDOS:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj.Majlinda Xhevat Poçi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 17.07.2025 Nr: 1352
Ora: 13:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë " zj.Majlinda Xhevat Poçi"